



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE - INDEPENDENT MEDIA COMMISSION

KUJTESA Sh.P.K.
Florent Perjuci
Drejtor
Prishtinë

Ankesën nr. 2010/10-KPM v Sh.P.K. KUJTESA
Ref: 1009/1121/KKPM/nr

VENDIM

Lidhur me Ankesën nr. 2010/10-Komisioni i Pavarur për Media (KPM) kundër Kujtesa sh.p.k. ("Pala Përgjegjëse")

Faktet

1. Këshilli i KPM-së më datën 29 maj 2008, ka vendosur që Palës Përgjegjëse t'i lëshoj licencën për të ofruar përmes sistemit kabllor shërbime të programeve kabllore për të cilat posedon marrëveshje valide për ritransmetim përmes rrjetit kabllor. Me marrjen e licencës Pala Përgjegjëse është obliguar që të respektoj Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës duke përfshirë Rregulloren për Distribuim Kabllorë CIMC-2007/04, dhe aktet tjera nënligjore të nxjerra nga KPM-ja.
2. Duke marr parasysh se Pala Përgjegjëse shumicën e programeve të ritransmetuara i kishte pa marrëveshje valide për ritransmetim, Këshilli i KPM-së më 1 shtator 2008, Palës Përgjegjëse i lëshoi Vendimin me gjobë Ref: 0809/1203/CIMC/sa, i cili ishte me kusht dhe do të hynte në fuqi nëse Pala Përgjegjëse gjatë kësaj periudhe do të transmetonte të paktën edhe një program pa marrëveshje valide mbi të drejtën autoriale.
3. Këshilli i KPM-së, duke u bazuar në ritransmetimin e vazhdueshme të programeve pa të drejtë për ritransmetim nga ana e Palës Përgjegjëse me datën 30 dhjetor 2009, i ka leshur vendim me gjobë Palën Përgjegjëse për shkeljen e nenit 2.1.1, 2.1.3 dhe 2.1.5 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës.
4. KPM edhe pas Vendimit me gjobë ka vazhduar me monitorimin e Palës Përgjegjëse ku me datën 5 shkurt 2010, ka gjetur se Pala Përgjegjëse edhe përkundër Vendimit me gjobë vazhdon të veproj në kundërshtim me nenin 2.1.1 dhe 2.1.3 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, duke ri-transmetuar filma pa marrëveshje valide për ritransmetim.
5. Më datën 10 shkurt 2010, KPM ka kërkuar nga Pala Përgjegjëse që brenda afatit prej 3 ditësh t'i sjell kopjet e kontratave valide me të cilat dëshmon se ka të drejtë në ritransmetimin e filmave në territorin e Republikës së Kosovës përmes platformës Tring.

Rruga Gazmend Zajmi #1, Prishtina - Gazmend Zajmi Street #1, Prishtina - Ulica Gazmend Zajmi #1, Prishtina

t. +381 (0)38 245 031 f. +381 (0)38 245 034 e. info@kpm-ks.org

Pala Përgjegjëse ka dështuar t'i ofrojë KPM-së dëshmitë për të drejtën e ritransmetimit të filmave të kërkuar nga KPM, duke vazhduar kështu veprimet në kundërshtim me nenin 2.1.1 dhe 2.1.3 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës dhe nenin 11.2 dhe 11.3 të Rregullores për Distribuim Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë CIMC-2007/04.

6. Gjithashtu, në bazë të raportit të monitorimit të datës 3 mars 2010, Pala Përgjegjëse është gjetur serish në shkelje duke ritransmetuar përmes kanalit Tring Max 21 filma pa të drejtë për ritransmetim, duke vepruar në kundërshtim me nenin 2.1.1 dhe 2.1.3 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës dhe nenin 11.2 dhe 11.3 të Rregullores CIMC-2007/04.
7. KPM, në bazë të raportit të monitorimit të datës 5 mars 2010, ka gjetur se Pala Përgjegjëse vazhdon të veproj në kundërshtim me nenin 2.1.1 dhe 2.1.3 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës dhe nenin 11.2 dhe 11.3 të Rregullores CIMC-2007/04, duke ritransmetuar përmes kanalit Tring Comedy 21 filma pa marrëveshje për ritransmetim.
8. Gjithashtu, në bazë të raportit të monitorimit të datës 10 mars 2010, Pala Përgjegjëse përsëri është gjetur në shkelje duke ritransmetuar përmes kanalit Tring Super 20 filma pa të drejtë për ritransmetim, që është në kundërshtim me nenin 2.1.1 dhe 2.1.3 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës dhe nenin 11.2 dhe 11.3 të Rregullores CIMC-2007/04.
9. Më datën 10 mars 2010, KPM ka kërkuar nga Pala Përgjegjëse që brenda afatit prej 3 ditësh t'i sjell kopjet e kontratave valide me të cilat dëshmon se Pala Përgjegjëse ka të drejtë të ritransmetoj filmat e platformës Tring. Pala Përgjegjëse ka dështuar t'i ofrojë KPM-së dëshmitë për të drejtën e ritransmetimit të filmave të kërkuar nga KPM, duke vazhduar veprimet në kundërshtim me nenin 2.1.1 dhe 2.1.3 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës dhe me nenin 11.2 dhe 11.3 të Rregullores CIMC-2007/04.
10. KPM me datën 16 mars 2010, përmes një shkrese ka kërkuar nga Pala Përgjegjëse që të veproj në pajtim me Ligjin e KPM-së, Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës si dhe me Rregulloren CIMC-2007/04, në të kundërtën KPM do të ndërmerr masa ligjore ndaj Palës Përgjegjëse.
11. KPM më datën 8 prill 2010, i ka dërguar Palës Përgjegjëse Njoftim për Shkelje të Kushteve dhe Termëve të Përgjithshme të Licencës konkretisht të nenit 2.1.1 dhe 2.1.3, si dhe të nenit 11.3 të Rregullores CIMC-2007/04, me këtë njoftim operatorit kabllorë i është lënë afat prej tre ditësh pas marrjes së njoftimit të përgjigjet rreth kësaj shkelje. Pala Përgjegjëse ka dështuar t'i ofrojë KPM-së përgjigjeje lidhur me shkeljet e bëra.
12. KPM serish me datën 7 maj 2010, ka bërë monitorimin e kanalit Tring Comedy të ritransmetuar nga Pala Përgjegjëse, dhe ka gjetur se Pala Përgjegjëse vazhdon të ritransmetoj 20 filma për të cilët nuk ka deponuar kontrata valide në KPM. Gjithashtu në bazë të këtij raporti është gjetur se Pala Përgjegjëse në kanalin Tring Super ka ritransmetuar 16 filma pa të drejtë për ritransmetim.
13. KPM po ashtu me datën 11 maj 2010, ka bërë monitorimin e kanalit Tring Max të ritransmetuar nga Pala Përgjegjëse dhe ka gjetur se Pala Përgjegjëse vazhdon të ritransmetoj 20 filma pa të drejtë për ritransmetim përmes kanalit Tring Max .
14. KPM më datën 20 korrik 2010, ka kërkuar nga Pala Përgjegjëse që brenda afatit prej 3 ditësh t'i sjell kopjet e kontratave valide me të cilat dëshmon se Pala Përgjegjëse ka të drejtë të ritransmetoj filmat e platformës Tring. Pala Përgjegjëse ka dështuar t'i ofrojë KPM-së dëshmitë për të drejtën e ritransmetimit të atyre filmave, duke vazhduar të veprojë

në kundërshtim me nenin 2.1.1 dhe 2.1.3 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës dhe nenin 11.2 dhe 11.3 të Rregullores CIMC-2007/04.

15. KPM më datë 5 gusht 2010, zyrtarisht i ka tërheq Vërejtjen Palës Përgjegjëse dhe e ka udhëzuar se për çfarëdo shkelje të mëtutjeshme nga ana e Palës Përgjegjëse do të pasojnë dënime me gjobë sipas nenit 20.1 pika c të Ligjit të KPM-së.
16. Në bazë monitorimeve të vazhdueshme të KPM-së, si dhe në bazë të ankesave të operatorit kabllorë IPKO, është gjetur se Pala Përgjegjëse vazhdon të veprojë në kundërshtim me nenin 2.1.1 dhe 2.1.3 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës dhe nenin 11.2 dhe 11.3 të Rregullores CIMC-2007/04, duke ritransmetuar filma pa të drejtë për ritransmetim.
17. KPM ka bërë monitorime të vazhdueshme dhe në bazë të raporteve të monitorimit dhe 14 ankesave të paraqitura nga operatori kabllor IPKO, Pala Përgjegjëse ka qenë në shkelje të nenit 2.1.1 dhe 2.1.3 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës dhe nenit 11.2 dhe 11.3 të Rregullores CIMC-2007/04, duke ritransmetuar filma pa të drejtë për ritransmetim.

Analiza Ligjore

18. Në bazë të nenit 2.1.1 i Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës përcaktohet që:

“Të licencuarit i kërkohet të veprojë në pajtueshmëri me Ligjin Nr. 2004/45 për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat Tjera të Përafërta si dhe ligjet tjera të zbatueshme në Republikën e Kosovës për pronësinë intelektuale, dhe në veçanti të sigurojë leje të vlefshme për të drejtën e autorit dhe leje për përdorimin veç e veç dhe në tërësi të të gjithë programeve komerciale që i bartë në listën e tij programore. Këtu përfshihet riprodhimi, ritransmetimi dhe ritransmetimi i njëkohshëm i sinjaleve të huaja dhe të importuara, qoftë nga emetues tokësorë të largët ashtu edhe nga sinjale dhe programe që transmetohen nga sateliti.”

- Gjithashtu, Neni 2.1.3 i Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës thekson:

“i licencuari nuk do të ri-transmetojë asnjë program pa marrëveshje valide mbi të drejtën autoriale. Bartja e kanaleve të programeve pa të drejtën autoriale përbën shkelje të rëndë të Kushteve dhe Termeve të Licencës dhe shkeljet e tilla rezultojnë me revokim të Licencës”.

Ndërsa neni 11.3 i Rregullores për Distribim Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë përcakton se:

“ Nëse një operator kabllor gjen se një shërbim i programit ka përmbajtje ilegale, edhe pse ai i kam ndërmarrë të gjitha masat e arsyeshme të kujdesit, operatori kabllor duhet ta ndërpres menjëherë shpërndarjen e mëtutjeshme të përmbajtjes ilegale dhe të ndërmarrë masa që të sigurohet se një gjë e këtillë nuk do të përsëritet.”

19. Pala Përgjegjëse ka vepruar në kundërshtim me Nenin 2.1.1, 2.1.3 dhe 2.1.5 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës si dhe me nenin 11.2 dhe 11.3 të Rregullores për Distribim Kabllor të Programeve Radio Televizive në Kosovë CIMC-2007/04, duke ritransmetuar 118 filma pa të drejtë për ritransmetim.
20. Me nënshkrimin e Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, KPM e ka njoftuar Palën Përgjegjëse lidhur obligimet që kanë operatorët kabllorë, duke i vënë theks të veçantë respektimit të të drejtës së autorit.

21. Duke pas parasysh vështirësitë rreth sigurimit të marrëveshjeve mbi të drejtën për ritransmetimin e programeve, KPM ka zgjatur disa herë afatin për operatorët kabllorë që t'ju mundëshet sigurimi i kontratave për ri-transmetimin e programeve.
22. Brenda afatit të përcaktuar në Njoftimet për Shkelje për sjelljen kontratave për ritransmetimin e filmave Pala Përgjegjëse ka dështuar të siguroj marrëveshje për ri-transmetim. Pala Përgjegjëse edhe pas marrjes së Vërejtjes vazhdon të jetë në shkelje.
23. Për më shumë edhe pse ishte njoftuar me shkrim nga KPM, për ritransmetim të programeve pa të drejtë dhe njëkohësisht është udhëzuar që të largojë nga ri-transmetimi të gjitha programet për të cilat nuk posedonte marrëveshje për ritransmetim, Pala Përgjegjëse vazhdon të ri-transmetojë 118 pa të drejtë për ritransmetim.
24. Bazuar në raportet e monitorimit të KPM-së si dhe në ankesat e operatorit Kabllor IPKO, Pala Përgjegjëse ka dështuar të ndërmarrë hapa të nevojshëm për të vepruar në pajtueshmëri me Rregulloren CIMC-2007/04 dhe Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës së KPM-së, respektivisht me Pjesën 3 të Licencës.
25. Këshilli i KPM-së, konstaton se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të Nenit 2.1.1 dhe 2.1.3 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës si dhe nenit 11.2 dhe 11.3 të Rregullores CIMC-2007/04 duke ritransmetuar 118 filma pa të drejtë për ritransmetim.

Vendim

26. Këshilli i KPM-së gjen se Pala Përgjegjëse ka bërë shkelje të Nenit 2.1.1 dhe 2.1.3 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, si dhe të nenit 11.2 dhe 11.3 të Rregullores për Distribim Kabllorë të Programeve Radio Televizive në Kosovë duke dështuar që të ri-transmetojë vetëm programet televizive për të cilat posedon marrëveshje mbi të drejtën për ri-transmetim.
27. Këshilli i KPM-së, vendosi që Pala Përgjegjëse të sanksionohet me gjobë për shkeljen e nenit 2.1.1 dhe 2.1.3 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës si dhe të nenit 11.2 dhe 11.3 të Rregullores për Distribim Kabllorë të Programeve Radio Televizive në Kosovë CIMC-2007/04.
28. Këshilli i KPM-së, mori Vendim që në bazë të Nenit 20.1 pika c të Ligjit të KPM-së, Pala Përgjegjëse të gjobitet me shumë prej 50.000.00 (pesëdhjetë mijë) euro për ri-transmetimin e 118 filmave pa të drejtë për ritransmetim.
29. Pala Përgjegjëse nga pranimi i këtijë Vendimi obligohet të mos ri-transmetojë asnjë program pa marrëveshje valide për ritransmetim, në të kundërtën Këshilli i KPM-së do të iniciojë procedura ligjore drejt suspendimit të licencës së Palës Përgjegjëse sipas nenit 20.1 të Ligjit të KPM-së dhe nenit 19 të Rregullores CIMC 2007/04.
30. Pala Përgjegjëse urdhërohet ta paguaj gjobën në vlerën totale prej 50.000.00 (pesëdhjetë mijë) euro, në xhirollogarinë e Ministrisë së Financave për "Depozitë Hyrëse" në emër të Buxhetit të Republikës së Kosovës-Komisioni i Pavarur për Media, në Autoritetin Qendror Bankar të Kosovës (AQBK)-Prishtinë, numër i xhirollogarisë: 1000-4000-7000-1635 brenda tridhjetë ditëve nga dita e pranimi të këtij vendimi apo, në rast të ankesës, në datën e vendimit me shkrim të Bordit të Mediave për Ankesa e cila mbështet apo modifikon gjobën.
31. Në rastë se Pala Përgjegjëse dështon të përmbush obligimin për gjobën e përcaktuar nga Këshilli i KPM-së në afat prej 30 ditësh nga pranimi i Vendimit, Këshilli i KPM-së do të iniciojë procedura ligjore drejt suspendimit të licencës së Palës Përgjegjëse sipas nenit 20.1 të Ligjit të KPM-së dhe nenit 19 të Rregullores CIMC 2007/04.

E drejta për Ankesë

32. Në pajtim me nenin 21.3 të Ligjit të KPM-së, Bordi i Ankesave për Media ("BAM") mund të dëgjoj dhe vendos për ankesat ndaj vendimeve të më poshtme të Këshillit të KPM-së:

"Dhënies, refuzimit, mos ripërtëritjes ose revokimit të lejes transmetuese: vemjes ose ndryshimit të kushteve të lejes së transmetimit me përjashtim të kushteve që kanë të bëjnë me caktimin e frekuencave apo kritereve tjera teknike: shqiptimit të sanksioneve dhe çështjeve tjera të ngjashme që mbështeten në urdhëresat administrative dhe në rregullore".

33. Neni 25.1 i Ligjit të KPM-së, kërkon që ankesat t'i parashtrohen Bordit të Ankesave për Media brenda afatit të parapare prej 30 ditësh që nga nxjerrja e Vendimit nga Këshilli i KPM-së. Ankesa duhet të jetë me shkrim dhe të përcillet me dokumente ose dëshmi që mund të kërkohen nga Bordi i Ankesave për Media në pajtim me nenin 24.2 (a) të Ligjit të KPM-së.
34. Bordi i Ankesave për Media ka të përcaktuara rregullat e tij të procedurës. Rregullat e procedurës të Bordit janë në dispozicion nga Zyra e Shefit Ekzekutiv të KPM-së, sipas kërkesës.

Lëshimi i Vendimit

Këshilli i KPM-së e lëshon këtë vendim




Filloreta Bytyqi
Kryesuese e Këshillit të KPM-së



28.09.2010
datë

Më këtë vërtetohet se Këshilli i KPM-së ka marrë këtë vendim në pajtueshmëri me rregulloret dhe ligjet e aplikueshme në Kosovë, dhe në pajtueshmëri me rregullat e procedurës së KPM-së.



Naife Selimaj Krasniqi
Shefe Ekzekutive

28.09.2010
datë